

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm - Divizioni civil**, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari Ahmet Idrizaj - Kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve porotë Xhavit Elezi dhe Ismet Këndusi – anëtar të trupit gjykues, në çështjen juridiko-civile të paditëses R. (M.) F. nga Gj., me banim në lagjen D. (Ish P.), kundër të paditurit Sh. (A.) V., nga Gj., me banim në lagjen D. (Ish P.), për besim, ruajtje, mbajtje dhe edukim të fëmijës, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor jo publik, të mbajtur me datë 29.08.2018, në prezencën e palëve ndërgjyqëse, me datë 26.09.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Fëmiju i mitur i përbashkët D. (Sh.) V. data e lindjes..., në Gj. i besohet në ruajtje, mbajtje dhe edukim nënës së tij - këtu paditëses R. (M.) F. ashtu që detyrohet i padituri Sh. (A.) V., që t'ia njohë këtë të drejtë paditëses në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

**CAKTOHET** kontakti personal i të paditurit Sh. (A.) V., nga Gj., më të miturin D. (Sh.) V., data e lindjes..., të premtën e parë dhe të tretë të çdo muaji nga ora 14:00/h, deri në ora 15:00/h, ashtu që ky kontakt realizohet nën mbikëqyrjen e nëpunësit për punë sociale në lokalet e Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë dhe **DETYROHET** paditësja R. (M.) F., që të miturin e lartë përmendur të e sjellë në lokalet e Qendrës për Punë Sociale, ditët dhe kohët e caktuar si më sipër, e më së largu në në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

**DETYROHET** i padituri Sh. (A.) V., nga Gj., që në emër të kontributit për mbajtjen e fëmijës së mitur D. (Sh.) V., të ia paguajë paditëses së lartpërmendur nga 60,00€ (gjashtëdhjetëeuro), për çdo muaj – duke filluar nga data 01.09.2018 e tutje në të ardhmen, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, ashtu që pagesa duhet të bëhet nga data 01 e deri më datën 05 të muajit në vijim për muajin paraprak, ndërsa këstet e arritura për pagesë t'i paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, ashtu që pagesa të i bëhet përfaqësueses ligjore – paditëses R. (M.) F., në afat e nën kërcënim si në pikën II – të këtij dispozitivi.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Paditësja në këtë gjykatë me datë 05.04.2018, ka parashtruar padi për besim, ruajtje, mbajtje dhe edukim të fëmijës. Ka potencuar faktin se : palët në procedurë, kanë hyrë në bashkësi jashtëmartesore me datë 07.07.2015, nuk kanë lidhur kurorë. Në bashkësinë jashtëmartesore, palët në procedurë kanë bashkëjetuar afro vite, pikërisht deri në muajin janar të vitit 2018. Palëve gjatë kësaj periudhe iu ka lindur fëmiju i tyre i përbashkët jashtëmartesor D.(Sh.) V., data e lindjes..., Marrëdhëniet jashtëmartesore në mes palëve ndërgjyqëse në fillim kanë qenë shumë të mira, mirëpo me kalimin e kohës kishte c' rregullime serioze të këtyre raporteve, ku për pasojë ka ardhur gjerë ke shkëputja faktike e bashkësisë jashtëmartesore, ashtu që nga muaji janar i vitit 2018 të njëjtit jetojnë ndaras njëri nga tjetri. Fëmija i përbashkët i quajtur D.(Sh.) V., është në përkujdesje, edukim, ruajtje dhe mbajtje të nënës së tij, paditëses në rastin konkret.

Paditësja në fjalën e saj përfundimtare deklarojë se: ka deklaruar se nga provat e administruara në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar themelësia e kërkesëpadsisë, ashtu që gjykatës i propozojë që të njëjën si të këillë të e miratojë.

Nuk kërkojë shpenzime procedurale.

I padituri në përgjigje në padi të parashtruar në këtë gjykatë me datë 17.05.2018, nuk e ka kontestuar faktin se me paditësen kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore afro 2 vjet, ku nga kjo bashkësi jashtëmartesore iu ka lindur edhe fëmiju i tyre i përbashkët D. (Sh.) V. data e lindjes..., Fëmija i lartpërmendur gjendet në përkujdesje të vazhduar dhe të pandërprerë te nëna e tij, këtu paditësja në rastin konkret. Më tej ka shtuar se në rastin konkret pajtohet që fëmiju i përbashkët i lindur nga bashkësia faktike jashtëmartesore i palëve në procedurë, të i besohet edhe më tutje në ruajtje, mbajtje dhe edukim paditëses në rastin konkret. I njëjti ka kërkuar nga paditësja që të ia mundësojë kontaktin me fëmijun e përbashkët të tyre.

Sa ju përket shpenzimeve procedurale, i njëjti deklarojë se: nuk ka asnjë mundësi të pagesës nga fakti se është përfitues i pensionit të veteranëve.

I padituri në fjalën e tij përfundimtare deklarojë se: në rastin konkret kërkojë nga gjykata që të vendosë në bazë të provave të administruara.

Nuk kërkojë shpenzime procedurale.

Gjykata pas vlerësimit të fakteve - juridike relevante, çmuarjes me ndërgjegje të provave të zbatuara dhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit, e në pajtim me nenin 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e themeltë dhe si e tillë u miratua.

Nga provat e zbatuara është argumentuar gjendja faktike si në vijim:

Në mes të palëve ishte jo kontestuese rrethana se palët në procedurë bashkësinë faktike martesore, e kanë shkëputur në muajin janar të vitit 2018 dhe që nga ajo kohë e tutje, të njëjtit jetojnë ndaras dhe që nga ajo kohë e tutje, fëmiju i tyre i përbashkët jashtëmartesor, është në përkujdesje të nënës së tij – këtu paditëses në rastin konkret.

Rrethanë tjetër jo kontestuese në mes të palëve ishte dhe fakti se i padituri realizon pensionin veteran në lartësinë mujore prej 170,00€.

Nga Ekstrakt i Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile Nr. E .... i lëshuar me datë 11.01.2018 në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, vërtetohet se fëmija i përbashkët i palëve në procedurë D.(Sh.) V., ka lindur me datë Data e Lindjes..., në Gj., nga nëna R. (M.) F. dhe babai Sh. (A.) V.

Nga Ekstrakt i Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile Nr. E .... i lëshuar me datë 05.04.2018 në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, vërtetohet se R. (M.) F., data e lindjes..., në fshatin S., Komuna e Gj., nga nëna V. F. dhe babai M. F.

Nga Ekstrakt i Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile Nr. E ..... i lëshuar me datë 29.08.2018 në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, vërtetohet se Sh. (A.) V., data e lindjes..., në Gj., nga nëna H.V. dhe babai A. V..

Nga Raporti i Qendrës për Punë Sociale - Organi i Kujdestarisë në Gjakovë, nën nr. punues ....., i datës 23.05.2018, është vërtetuar se: për shkak të konflikteve të vazhdueshme në mes të palëve, jeta e tyre e përbashkët në bashkësinë faktike jashtëmartesore, është bërë e padurueshme, andaj shkëputjen e kësaj bashkësie jashtëmartesore, palët e kanë vlerësuar si zgjidhje të vetme. Meqenëse të njëjtëve gjatë bashkësisë faktike jashtëmartesore, ju ka lindur me datë ....., fëmija i tyre i përbashkët D. (Sh.) V. dhe nëna e tij këtu paditësja në rastin konkret është në vazhdimësi duke u kujdesur për të, ashtu që edhe Q.P.S Organi i Kujdestarisë, duke u nisur nga fakti se fëmija është shumë i vogël dhe ende ushqehet me qumshtin e nënës e cila luan rolin kryesor në procesin e zhvillimit të fëmijës, vlerëson se i njëjti duhet t'i besohet në kujdes, rritje dhe edukim nënës së tij – këtu paditëses.

Gjykata faktike në rastin konkret, poashtu është e mendimit që për shkak të moshës së fëmijës së përbashkët të palëve në procedurë, i njëjti edhe tani e tutje, duhet t'i besohet në ruajtje, mbajtje dhe edukim, nënës biologjike të tij, meqë është duke jetuar me të që nga koha e lindjes dhe në këtë kontekst të njëjtit janë të lidhur emocionalisht në mes veti. Ky qëndrim i gjykatës gjenë mbështetje edhe në dispozitën ligjore të nenit 139 paragraf.2 të Ligjit për Familjen i Kosovës (Ligji nr.2004/32) dhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve, për çka u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket çështje së kontaktit të fëmijës të përbashkët jashtëmartesor të palëve në procedurë dhe duke pasur parasysh faktin se të njëjtat kontakte të fëmijës me prindin (të cilit nuk i është besua në ruajtje, mbajtje dhe edukim) - të paditurit, është në interesin më të mirë të fëmijës që të ketë kontakte me të dy prindërit, në mënyrë

që të ketë një rritje sa më të mirë dhe duke u mbështetur edhe në dispozitën ligjore të nenit 140 par. 3 të LFK-së, të para cituar, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket çështjes së alimentacionit, gjykata në rastet e këtillë kujdeset Ex Officio, kështu që duke pasur parasysh nevojat e fëmijës dhe moshën e të njëjtit, konsideron se i padituri ka obligim ligjor, si prind i fëmijës që për çdo muaj, të kontribuojë për plotësimin e kushteve të domosdoshme për fëmijën e përbashkët të palëve në procedurë, ashtu që duke pasur parasysh edhe faktin se i njëjti ka mundësi financiare që të të ia paguajë për çdo muaj shumën prej 60,00€ dhe atë duke filluar nga data 01.09.2018 e tutje, përderisa të ekzistojnë kushtet ligjore dhe një obligim i këtillë rezulton edhe nga parimi i përcaktimit të mbajtjes dhe alimentacionit, siç parasheh neni 330 par. 1 dhe 2, lidhur me par. 3 të Ligjit për Familjen i Kosovës, me bindje se shumta e gjykuar është në pajtim real me nevojat e fëmijës dhe me mundësitë reale, që i ka për momentin i padituri si baba biologjik i tij dhe për këtë arsye gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 450 të LPK-së, dhe deklaramit të palëve në procedurë.

Nga të lartë cituarat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**C.nr.179/2018 datë 26.09.2018**

**KRYETARI I TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTARI,**  
**Ahmet Idrizaj**

**UDHËZIM JURIDIK;** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.